

Tiranë më, 27.05.2021

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“MEDIATIO” SH.P.K

KAPITULLI I

THEMELIMI, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 – Themelimi, Forma dhe Ortakët

Shoqëria “MEDIATIO” SH.P.K (më poshtë referuar “Shoqëria”) është e krijuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga ortakët si më poshtë:

- **Z. ALENTIN DERVISHI**, i biri I Sadik dhe Floreta, lindur më 17.09.1975, në tiranë, SHQIPERI dhe banues në Sheshi Gjeneral Jozef San Martin, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës I Kartës së Indetitetit H50917097N.
 - **Z. ELTON MUÇAJ**, i biri I Shpetim dhe Muavez, lindur më 30.03.1976, në Tiranë, SHQIPERI dhe banues në Rrugën “Qemal Stafa”, Pallati 343, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit H60330188W.
 - **Z. TEDI ÇOPJA**, i biri I Agim dhe Lumturi, lindur më 23.06.1986, në Elbasan, SHQIPERI dhe banues në lagjen 11 Nentori, pallati 580, Elbasan, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës I Pasaportes I60623096F.
-
- Shoqëria do të funksionojë sipas legjislacionit shqiptar.
 - Statuti është në përpunje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është “MEDIATIO” SH.P.K

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :

- Import – Export mallrash,Naftë dhe produktet e naftës,Ari dhe produktet e arit. Shitje – Blerje mallrash të ndryshme.Ndërmjetsim ndërkombëtar. Shoqëria mund të kryej cdo aktivitet tjeter të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 4 - Selia

Selia e shoqërisë është në adresën Njësia Bashkiake nr.3, Rruga Qemal Stafa , Pallati 343, Shkalla 7,Kati 1, Apartamenti 1, Tiranë.

- Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjeter bëhet me Vendim të Asamblesë së Ortakëve .
- Asambleja e Ortakëve mund të vendllohet hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 5 - Kohëzgjatja e veprimtarisë


- Kohëzgjatja e veprimtarisësë Shoqërisë do të jetë e pakufizuar.
- Shoqëria mund të prishet përpëra këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

Neni 6 – Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- Ky Kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaket e shoqërisë Z. TEDI ÇOPJA, në vlerën 51.000 (pesëdhjetë e një mijë) lekë ,përkatesisht 51% (pesëdhjetë e një) përqind të kapitalit të shoqërisë, Z. ELTON MUÇAJ, në vlerën 24.500 (njëzet e katër mijë e pesë qind) lekë, përkatesisht 24.5% (njëzet e katër pikë pesë) përqind të kapitalit të shoqërisë dhe Z. ALENTIN DERVISHI, në vlerën 24.500 (njëzet e katër mijë e pesë qind)



lekë, përkatesisht 24.5% (njëzetë e katër pikë pesë) përqind të kapitalit të shoqërisë, Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve .

- Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 3 kuota jo të barabarta.

Neni 7 - Rritja e kapitalit themeltar

- Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
- Në rast rritjeje të kapitalit, kuotat e ortakëve të shoqërisë do të rriten sipas shumave të përcaktuara në vendimin e Asamblesë së Ortakëve .

Neni 8 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë të Ortakëve të Shoqërisë . Në cdo rast, kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 9 – Organi Vendimmarrës

- Vendimet e shoqërisë “MEDIATIO” SH.P.K merren nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë.

Neni 10 – Administrimi

- **Z. ALENTIN DERVISHI** , i biri I Sadik dhe Floreta, lindur më 17.09.1975, në tiranë, SHQIPERI dhe banues në Sheshi Gjeneral Jozef San Martin, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës I Kartës së Indetitetit H50917097N.

- Afati i mandatit të Administratorit do të jetë 5 vjet , me të drejtë ripërtëritje.
- Administratori do të ushtrojë të gjithë kompetencat sipas parashikimeve të nenit 95 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërите tregtare” dhe sipas Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”.
- Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose për kategori aktesh.
- Organi Administrativ ka të drejtë dhe duhet të :
 - a) Kryejë me mirëbesim të gjitha veprimet e administritmit të veprimtarisë tregtare te shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakëve e në interesin më të mirë të shoqërisë në terësi.
 - b) Përfaqësojë shoqërinë tregtare.
 - c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.
 - ç) Përgatit dhe nënshkruaj pasqyrat financiare vjetore, dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim.
 - d) Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,
 - dh) Raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimtarive të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimitainë e shoqërisë tregtare.
 - e) Marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta.
 - f) Përfaqësojë apo emërojë përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria ose në çështje të tjera me palë të treta.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 11 – Viti finanziar dhe bilanci vjetor

- Viti finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të secilit vit.
- Viti i parë finanziar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortakja e vetme e shoqërisë.
- Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin finanziar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vittit finanziar.

KAPITULLI V

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 12 – Prishja e shoqërisë

- Shoqëria mund të prishet në çdo kohë me Vendim të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë, si dhe në rastet e parashikuara nga neni 99 i Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- Në rastin e prishjes së shoqërisë, Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidatorë. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët, duke likuiduar në rradhë të parë detyrimet nga punonjësve, shtetit e më pas ndaj të tretëve. Në rastin e tepricës së kapitalit të shoqërisë me perfundimin e likuidimit, kjo i shpërndahet Ortakëve. Nëse ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 13– Legjislacioni

- Për sa nuk është shkruar në këtë Statut, do të bëhet në referim me dispozitat e legjislacionin shqiptar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.


Neni 14– Gjuha

- Ky statut është i përbërë në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe, që kanë vlerë të njëjtë ligjore.


ORTAKET E SHOQËRISË

“MEDIATIO” SH.P.K’


Z. ELTON MUÇAJ


Elton Muçaj

Z.TEDI ÇOPJA


Tedi Copja

Z.ALENTIN DERVISHI


Alentin Dervishi